

ADOPTIMI-MBROJTJE JURIDIKE PËR FËMIJËT PA PRINDËR DHE PA PËRKUJDESJE PRINDËRORE SIPAS LEGJISLACIONIT TË RM-SË

Arta SELMANI*

Abstrakt :

Pas sjelljes së Ligjit mbi familjen në RM në vitin 1992, janë bërë plotësime dhe ndryshime të tij në zbatimin e masave juridiko-familjare për mbrojtjen juridiko-familjare të fëmijëve, mirëpo çështja e zbatimit të dispozitave ligjore sa i përket respektimit të të drejtave të fëmijëve pa prindër dhe pa përkujdesje prindërore nuk është në nivel të duhur në Republikën e Maqedonisë, si nga ana e institucioneve kompetente gjithashtu edhe nga ana e personave tjerë përgjegjës për përkujdesjen e fëmijëve.

Roli i fëmijëve në përgjithësi, pa marrë parasysh statusin e tyre familjar duhet të jetë në nivel primar në një shtet juridik dhe në një shoqëri demokratike.

Qëllimi i punimit konsiston në:

- paraqitjen e rekomandimit për aplikimin e adoptimit si formë juridike më e përshtatshme për mbrojtjen e fëmijëve pa prindër dhe pa përkujdesje prindërore,
- aplikimin e masave juridiko-familjare dhe domosdoshmërinë e respektimit të të drejtave të garantuara me ligj nga organet kompetente dhe adoptuesit,
- domosdoshmërinë për sensibilizimin e ofrimit të shërbimeve nga institucionet kompetente për vendosjen e fëmijës në adoptim,
- realizimin e reformave për rregullim juridik serioz të të drejtave të fëmijëve të adoptuar,
- nevojën për përpilimin e një ligji special në këtë fushë të së drejtës familjare (mbrojtja juridike e fëmijëve pa prindër dhe pa përkujdesje prindërore, me theks të veçantë mbrojtjen e fëmijëve të adoptuar),
- rëndësinë e respektimit të interesit të fëmijëve pa prindër dhe pa përkujdesje prindërore dhe mundësia që institucioni i adoptimit iu ofron fëmijëve dhe personave të interesuar të ushtrojnë të drejtën prindërore.

Korniza e pamjaftueshme ligjore në këtë pjesë të së drejtës, gjithsesi mund të plotësohet me anë të ndryshimeve dhe plotësimeve të ligjit aktual mbi familjen në pjesën që u dedikohet të drejtave familjare të fëmijëve e sidomos fëmijëve të adoptuar, si dhe ligjeve tjera të veçanta që rregullojnë të drejtat e këtyre fëmijëve jashtë familjes. Mirëpo, përkundër ndryshimeve që mund të bëhen, procesi i përpilimit të një ligji special është më se i nevojshëm.

Është me rëndësi të veçantë çështja e miratimit dhe ratifikimit të mekanizmave ndërkombëtarë që rregullojnë adoptimin e fëmijëve pa prindër apo pa përkujdesje prindërore.

Rekomandimi deri tek qeveria, Ministria për punë dhe politikë sociale, Qendrat për shërbime sociale dhe institucionet tjera relevante, për disa ndryshime në këtë fushë të së drejtës, gjithsesi është pjesë e reformave ligjore dhe realizimi me përgjegjësi i këtyre reformave do të përmirësoj dukshëm nivelin familjar dhe shoqëror të fëmijëve.

Fjalët çelës: adoptimi-mbrojtje juridike më e përshtatshme, mbrojtja e interesit më të lartë të fëmijëve të adoptuar, mbrojtja juridiko-sociale e fëmijëve pa prindër dhe pa përkujdesje prindërore, përpilimi i ligjit special për rregullimin e mbrojtjes juridike fëmijëve pa prindër dhe pa përkujdesje prindërore.

* Fakulteti i Drejtësisë, Universiteti i Evropës Juglindore, Tetovë, Maqedoni.

Hyrje

‘Fëmija, i lindur apo i adoptuar, meriton të njëjtën dashuri dhe përkujdesje’.

Të shkruash për adoptimin është një temë shumë e prekshme në esencën e saj, sepse prek pjesën më të ndjeshme të shoqërisë-fëmijët.

Pjesa më me interes në një shoqëri, gjithsesi janë fëmijët dhe mirërritja e tyre është një aspekt shumë i rëndësishëm, të cilës duhet dhënë prioritet. Të gjithë fëmijët duhet të kenë fatin për të jetuar në një familje dhe shoqëria me mekanizmat e saj duhet të angazhohet që këtë t’ua sigurojë. Të njëjtin fat nuk e kanë të gjithë fëmijët dhe kjo është një fatkeqësi e të gjitha kohërave, madje edhe e kohës sonë.

Kur përmendi çështjen se të njëjtin fat nuk e kanë të gjithë fëmijët, e kam fjalën pikërisht për kategorinë e fëmijëve të cilët janë të privuar nga jeta familjare, për shkaqe të ndryshme, për veprimin e të cilëve ata aspak nuk janë fajtor. Ata janë fëmijë të cilët kanë nevojë për siguri, dashuri dhe përkujdesje prindërore.

Adoptimi nuk është një kontratë, një marrëveshje, por është formë dhe masë ligjore për:

- mbrojtjen e fëmijëve nevojtar,
- plotësim i nevojës për të pasur fëmijë çiftet që në rrugë biologjike nuk mund të lindin, dhe
- kryerje e një gjesti human nga personat që kanë fëmijë, por kanë mundësi materiale të adoptojnë fëmijë për t’u ofruar strehë familjare.

Rregullimi ligjor i institucionit të adoptimit klasifikohet në kategorinë e institucioneve më pak të përpunuara në kuadër të së drejtës familjare dhe sociale në Republikën e Maqedonisë.

Korniza e pamjaftueshme ligjore në këtë pjesë të së drejtës, mund të riparohet me anë të ndryshimeve dhe plotësimeve të ligjit aktual mbi familjen në pjesën që u referohet të drejtave dhe masave juridiko-familjare për mbrojtjen e fëmijëve në përgjithësi dhe fëmijëve të adoptuar në veçanti, si dhe ligjeve tjera të veçanta që rregullojnë statusin e këtyre fëmijëve. Mirëpo, përkundër ndryshimeve që mund të bëhen, procesi i përpilimit të një ligji special (*lex specialis*) është më se i nevojshëm, madje i domosdoshëm.

Është me interes dhe rëndësi të veçantë edhe çështja e miratimit dhe ratifikimit të akteve (dokumenteve) juridiko- ndërkombëtare që rregullojnë sferën e adoptimit të fëmijëve pa prindër dhe pa përkujdesje prindërore, respektivisht përfshirjen e tyre në kuadër të kornizës ligjore nacionale.

ADOPTIMI – mbrojtje juridike më e përshtatshme

Çdo fëmijë ka të drejtë për përkujdesje dhe rritje në një familje funksionale dhe të shëndoshë. Këtë do ta ndërlihd edhe me dispozitën ligjore se: Një nga të drejtat elementare të fëmijëve është edhe e drejta të jetojë me prindërit e tij (Ligji mbi familjen, neni 50 al.1 Gazeta Zyrtare e RM-së nr.83/2004).¹ Mirëpo kjo e drejtë e fëmijëve mund të kufizohet me disa pengesa të natyrës juridike ose faktike. Ky lloj kufizimi, nuk konsiston në humbjen e të drejtës për të jetuar me prindërit, por konsiston në pamundësinë e realizimit të së drejtës. Kufizimi i jetës me prindërit, në njërin anë paraqet edhe mundësin e adoptimit të fëmijës. Me dhënien e fëmijës në adoptim ai vazhdon jetën pa prindërit e tij.²

Në Republikën e Maqedonisë, çështja e fëmijëve të adoptuar është e rregulluar me Ligjin mbi familjen të vitit 1992,³ dhe me disa ligje tjera të veçanta, edhe atë me Ligjin mbi mbrojtjen sociale (Gazeta Zyrtare e RM-së nr.21/2006), Ligjin mbi trashëgiminë (Gazeta Zyrtare e RM-së nr. 47/1996), Ligjin për emrin personal (Gazeta Zyrtare e RM-së nr. 08/1995), Ligjin mbi evidencën amë (Gazeta Zyrtare e RM-së nr. 08/1995), Ligjin mbi të drejtën ndërkombëtare private (Gazeta Zyrtare e RM-së nr. 87/2007), Ligjin mbi shtetësinë (Gazeta Zyrtare e RM-së nr.45/2004). Republika e Maqedonisë gjithashtu ka ratifikuar Konventën Evropiane për adoptimin e fëmijëve (Gazeta Zyrtare nr.12/2002).

¹ Në punim janë shfrytëzuar nenet sipas tekstit të spastruar të Ligjit mbi familjen, Gazeta Zyrtare nr.83/2004.

² Mira Alinčić, Dubravka Hrabar, Dijana Jakovac-Lozić, Aleksandra Korać, *Obiteljsko pravo*, Zagreb 2007, fq.319.

³ Ndryshime dhe plotësime të këtij ligji janë bërë me: Ligji për ndryshime dhe plotësime të ligjit mbi familjen, Gazeta Zyrtare e RM-së nr.09/1996; Ligji për ndryshime dhe plotësime të ligjit mbi familjen, Gazeta Zyrtare e RM-së nr.38/2004; Ligji për ndryshime dhe plotësime të ligjit mbi familjen, Gazeta Zyrtare e RM-së nr.33/2006.

Ndërlidhur me këtë, duhet shtruar faktin se, Ish-Republika Socialiste e Maqedonisë ka pasur në fuqi ligj të veçantë i cili ka rregulluar institucionin e adoptimit, Ligji mbi adoptimin e fëmijëve i vitit 1973, kurse në vendet e Ish-Jugosllavisë gjithashtu ka patur ligj mbi adoptimin e fëmijëve i vitit 1947, respektivisht Ligji themelor mbi adoptimin i vitit 1965.

Mirëpo, duke i dhënë prioritet rëndësisë së mbrojtjes ligjore dhe institucionale të kësaj kategorie të fëmijëve, është më se i nevojshëm përpilimi i një ligji të veçantë i cili do të përmbante dispozita kryesisht për mbrojtjen juridike të fëmijëve pa prindër dhe pa përkujdesje prindërore, pra siç janë: vendosja e fëmijëve në familje tjetër ⁴, vendosja e fëmijëve në jetimore, adoptimi dhe kujdestaria ndaj tyre ⁵.

Duhet pasur parasysh se, bazën jetësore fëmija e fiton në familje ku mëson se si të jetoj, çka të vlerësojë, çfarë qëndrimi të ketë ndaj suksesit dhe mossuksesit, t'i pranojë dhe shprehë ndjenjat e veta. ⁶ Parashtrohet pyetja, se cila është mbrojtja më e përshtatshme dhe më e sigurt e cila mund t'u ofrohet fëmijëve të privuar nga mundësia që të përjetojnë ngrohtësinë e vatrës familjare? Duke i dhënë prioritet kujdesit dhe dashurisë që mund t'ua ofrojnë çiftet që nuk kanë fëmijë, pa dyshim, *adoptimi* është rruga më e sigurt që një fëmijë të ndjehet pjesë e një familje, të ketë siguri nga personat me të cilët jeton dhe të ndjejë sinqeritetin e dashurisë prindërore.

A.M (10 vjeçar) tregon se jeta e tij do të ishte më e lumtur nëse do të kishte një nënë e cila do t'ia përgatiste ushqimin dhe do t'ia pastronte teshat, dhe një baba me të cilin bashkërisht do të punonin për të siguruar kafshatën e bukës, qofshin ato edhe të ashtuquajtur prind adoptues, e jo ai të bredh i vetëm rrugëve dhe të hajë çka të gjejë dhe kush çka ti jep. Ai nuk njeh prindërit e tij, dhe bën apel tek të gjithë fëmijët që jetojnë me

⁴ Fëmijët e vendosur në familje tjetër, duke mos qenë të kënaqur nga kjo masë juridike e cila iu është shqiptuar, kanë bërë peticion deri tek Shoqata e fëmijëve pa prindër nga jetimoret e fëmijëve në RM "Ardhmëria", me arsyetim se do të ishte më e arsyeshme që ndaj tyre të zhvillohet procedura e adoptimit. Kjo shoqatë do të zhvillojë kampanjë për ndryshimin e dispozitave të Ligjit mbi familjen sa i përket adoptimit, sipas kësaj shoqate "Fëmijët pa prindër janë për adoptim, e jo për vendosje në familje tjetër të cilët familje më së shpeshti janë të motivuar nga ndihma materiale prej 5.000 den që e marrin për përkujdesjen e këtyre fëmijëve. Marrë nga "Utrinski Vesnik"-15 Dhjetor 2007.

⁵ Sipas të dhënave statistikore të datës 30.05.2008, gjatë vitit 2007 në kujdestari janë vendosur gjithsej 802 fëmijë, prej të cilëve 679 janë larguar nga familja për shkak të problemeve familjare, 7 për shkak të devijimeve në personalitet dhe sjellje, 61 fëmijë për shkak të pengesave psikike, 16 fëmijë për shkak të pengesave fizike, dhe 39 fëmijë për shkaqe tjera.

⁶ Cvetanka Siljanoska-Kostadinoska, *Posvojuvanjeto kako eden od vidovite na zastita na decata*, Shkup 2005, fq.5

prindërit e tyre, se lumturia më e madhe në botë është të kesh prindër, duke mos i marrë parasysh rrethanat tjera.

Korniza e Ligjit mbi familjen i RM-së lidhur me aplikimin e masave juridike për vendosjen e fëmijëve në adoptim dhe mbrojtjen e tyre

- ***Përkufizimi i adoptimit***

Legjislacioni mbi të drejtën familjare në RM (Gazeta Zyrtare e RM-së nr.83/04), çështjen e vendosjes së fëmijës në adoptim e rregullon me një numër të kufizuar të neneve, prej nenit 110 deri në nenin 155.

Neni 110 al.1 përmban përkufizimin e institucionit të adoptimit:

Me adoptim krijohen marrëdhënie si ato të cilat krijohen me lindje (adoptim i plotë) apo vetëm marrëdhënie të cilat ekzistojnë në mes prindërve dhe fëmijëve (adoptim jo i plotë).

Konsideroj se, ky ligj jep një definicion shumë të thukët dhe jo të plotë sa i përket adoptimit, duke mos i përmbajtur elementet esenciale të cilët do ta kishin sqaruar në thelb këtë institucion, edhe atë, qëllimin, mënyrën e themelimit të kësaj marrëdhënie dhe kategorinë e fëmijëve që mund të adoptohen dhe personave të cilët mund të adoptojnë.

Për të dhënë definicionin e ADOPTIMIT, duhet theksuar disa elemente shumë të rëndësishme, që një nocion e bëjnë më komplet dhe më të qartë.

Autorë të ndryshëm japin definicione të ndryshme sa i përket nocionit të adoptimit.

P.sh Sipas koautorëve të librit ‘Obiteljsko pravo’ - Mira Alinčić, Dubravka Hrabar, Dijana Jakovac-Lozić, Aleksandra Korać-Graovac- Adoptimi paraqet një institut juridiko-familjar, me anë të cilit në rrugë juridike themelohet marrëdhënia prindërore midis fëmijës së mitur të huaj (i adoptuari) dhe një personi madhor (adoptuesi), edhe atë me një akt juridik të organit kompetent (fq. 318).

Profesor Gani Oruçi, nuk jep një definicion në kuptimin klasik lidhur me atë se çka në të vërtetë kupton me adoptim. Sipas tij : Midis adoptuesit dhe të adoptuarit themelohet marrëdhënie e ngjashme me marrëdhëniet midis prindërve dhe fëmijëve. Sipas profesorit Gani Oruçi , vet akti i themelimit të adoptimit është kontratë në formë

solemne, kurse marrëdhënia që krijohet me anë të kësaj kontrate është marrëdhënie e adoptimit, ose familje sipas adoptimit (E drejta familjare, Prishtinë, 1994, fq.179).

Me birësim ⁷ vendoset midis birësuesit dhe të birësuarit një marrëdhënie birësie, e cila imiton atë natyroren (*adoptio enim naturam imitatur*). ⁸

Adoptimi paraqet institucion juridik dhe shoqëror, me anë të cilit midis adoptuesve dhe fëmijëve të adoptuar themelohet marrëdhënie prindërore, të cilat, varësisht nga lloji i adoptimit janë identike me marrëdhënien prindërore, adoptimi themelohet me akt juridik, d.m.th., në rrugë artificiale, e jo në rrugë natyrore si gjinia e gjakut (martesore dhe jashtëmartesore), ashtu që gjinia sipas adoptimit njihet si gjinia civile.⁹

Pra, adoptimi paraqet institucion shoqëror dhe juridiko- familjar, me anë të të cilit krijohet marrëdhënie prindërore, me anë të një akti juridik të dhënë nga ana e organit kompetent, i cili akt përcakton rrugën artificiale të themelimit të kësaj marrëdhënie, por qëllimi dhe funksioni i të cilës imiton natyroren ashtu që fëmijëve pa prindër dhe pa përkujdesje prindërore u mundëson plotësimin e kësaj mungese familjare, dhe çifteve që nuk kanë fëmijë u mundëson plotësimin e qëllimit të pasjes së fëmijës, kurse personave që kanë fëmijë realizimin e një akti human, dhe në këtë mënyrë duke themeluar gjininë e adoptimit midis adoptuesit dhe të adoptuarit me të paslindurit e tij (adoptimi jo i plotë) ose themelohet gjini adoptimi midis adoptuesit dhe kushërinjve të tij me të adoptuarit dhe pasardhësit e tij (adoptim i plotë).

⁷ Në legjislacionin familjar të Shqipërisë birësimi nënkupton adoptimin e fëmijës (BIRËSUAR- që është bërë bir a bijë në shpirt, që është birësuar nga dikush. Ky sqarim i fjalës *birësim* jepet në Fjalorin e shqipes së sotme, Tiranë, 1984, fq. 88). Nga personat të cilët nuk merren me shkencën e së drejtës familjare mund të nënkuptohet si adoptim i fëmijës së gjinisë mashkullore. E BIRË-sojmë një fëmijë, për ta kuptuar institucionin e adoptimit, fjala birësim nuk do të ishte edhe aq e përshtatshme, sepse anashkalon BIJËsimin, në aspektin teknik të fjalës, jo edhe në përmbajtjen dhe qëllimin e vet institucionit të adoptimit. Ndërkaq, në kodin civil shqiptar të vitit 1929 është aplikuar nocioni Adoptim, dhe ky institucion rregullohet me nenet 257- 274, kurse nocioni Bijësim është përdorur për pranimin(njohjen) e fëmijëve legjitim dhe fëmijëve të lindur deri sa vazhdon martesja (neni 225- 240)..

⁸ Arta Mandro-Bilalli, Vjollca Meçaj, Tefta Zaka, Arjana Fullani, *E drejta familjare*, Tiranë, 2006, fq.643

⁹ Liljana Spirovic, *Semejno Pravo*, Shkup, 2004, fq.169

Kushtet për themelimin e adoptimit

Sa u përket kushteve për themelimin e adoptimit, që në fakt edhe janë nën kornizën e masave juridike për vendosjen e një fëmije në adoptim, Ligji mbi familjen përmban kushtet që një fëmijë duhet t'i plotësoj që të adoptohet, kushtet që një person duhet t'i plotësoj për të adoptuar fëmijë si dhe kushtet formale dhe materiale të organit kompetent për zhvillimin e procedurës për themelimin e adoptimit.

Në këtë punim do të fokusohem vetëm në aplikimin e masave juridike ndaj fëmijës që duhet të adoptohet.

- ***Kushtet lidhur me të adoptuarin***

Masat juridike për vendosjen e fëmijës në adoptim duhet të zbatohen duke pasur pikësynim kryesor ***Interesin dhe Sigurimin e fëmijës***.

Ligji shprehimisht parasheh se, vetëm personi i mitur mund të adoptohet, edhe atë përcakton moshën minimale për vendosjen e fëmijës në adoptim (Adoptimi mund të themelohet më herët pas moshës tre muajsh të fëmijës).¹⁰ Është periudha kur fëmija më mirë mundet t'u përshtatet kushteve në familjen e re, duke mos e ndier mungesën e prindërve biologjik e sidomos të nënës. Kur fëmija adoptohet në moshën kur tani më e ka të njohur faktin se nuk ka kush të përkujdeset për të, atëherë është pak më vështirë që karakterit dhe nevojave të fëmijës t'u përshtaten kushtet në të cilët jetojnë adoptuesit.

K.I (15 vjeçare)- I kam pasur shumë të vështira momentet kur kam ardhur në shtëpi të re, në një mes të ri familjar. Në fillim dëshiroja të qëndroja vetëm dhe më vinte turp nëse nuk dija të sillesha në situata të caktuara, mirëpo me kalimin e kohës u jam përshtatur kushteve dhe rrethanave dhe mund të them se i ndjej si prindër të mi njerëzit me të cilët jetoj, sepse edhe ato më kanë pranuar si vajzën e tyre.

Sipas Konventës evropiane për adoptim (2008) dhe Konventës evropiane për adoptimin e fëmijëve të vitit 1967, parashikohet adoptimi i fëmijës, i cili në momentin e paraqitjes së kërkesës për adoptimin e tij/saj nga ana e adoptuesit, të mos ketë mbushur moshën 18

¹⁰ Neni 139, al.2, Ligji mbi familjen i RM-së,

vjeçare, të cilët nuk janë dhe nuk kanë qenë në martesë, nuk janë dhe nuk kanë hyrë në një partnership të regjistruar ¹¹ (këtë e parasheh vetëm Konventa e re evropiane për adoptim e vitit 2008), dhe sipas ligjit mos të llogariten madhor. ¹² Ligji aktual mbi familjen i RM-së, nuk precizon, çështjen e miturisë së fëmijës, por përcakton se: Vetëm fëmija i mitur mund të adoptohet (neni 111), duke mos përcaktuar si pengesë martesën e tij. Parashtrrohet pyetja se çfarë masash do të zbatohen në rast të bashkëjetesës së dy fëmijëve pa prindër dhe pa përkujdesje prindërore, të cilët jetojnë në jetimore ose në rrugë? Në këto raste, duhet të parashihen dhe të zbatohen metoda speciale të cilat nuk do të dëmtonin dinjitetin e këtyre fëmijëve.

Para se gjithash, Organi kompetent për vendosjen e fëmijës në familjen e adoptuesit dhe prindërit e ardhshëm (adoptuesit) duhet të kenë parasysh ***Interesin e fëmijës***, i cili interes përfshin në vete edhe qëllimin e institucionit të adoptimit. Ky interes i fëmijës, përveç Ligjeve nacionale,¹³ garantohet edhe me dokumentet ndërkombëtare të cilët rregullojnë këtë çështje. ¹⁴

Me anë të adoptimit realizohen qëllimet dhe plotësohen nevojat e fëmijës, shoqërisë, adoptuesve si dhe prindërve biologjik të cilët nuk kanë kushte materiale për përkujdesjen e fëmijës. Mirëpo, si qëllim primar për adoptim është respektimi i *Interesit të fëmijës*. Tani parashtrrohet pyetja, ky interes është i natyrës materiale apo shpirtërore? Nëse merren parasysh, kushtet në të cilët jetojnë dhe standardin ekonomik në shtetin tonë,

¹¹ Ndër ndryshimet tjera nga Konventës evropiane për adoptimin e fëmijëve e vitit 1967, Konventa evropiane për adoptim (2008) parashikon edhe dispozita për çifte heteroseksuale të pamartuara që kanë hyrë në një partnership të regjistruar në shtetet të cilat i njohin këto institucione dhe tek beqarët. Ai lë Shtetet gjithashtu të lira të shtrijnë adoptimet tek çiftet homoseksuale dhe çifte me të njëjtën gjini që jetojnë së bashku në një lidhje të qëndrueshme. Gjetendet në:

http://www.ifsw.org/en/p38001352.html?force_folder=038000059

¹² Neni 1 Konventa evropiane për adoptim (viti 2008), neni 3 i Konventës evropiane për adoptimin e fëmijëve e vitit 1967

¹³ Ligji mbi familjen i RM-së (neni 112); Ligji për procedurat e birësimit dhe Komitetit shqiptar të birësimit, Nr.9695, viti 2007; Ligji mbi familjen i Kroacisë, nr.116/2003 (neni 125, al.1); Ligji për familjen i Kosovës, Nr.32/2004(neni 163, al.1 *Adoptimi i fëmijës është i lejuar nëse i shërben mirërritjes së fëmijës dhe nëse pritet që mes prindit adoptues dhe fëmijës të krijohet marrëdhënia prind-fëmijë*, pra nuk përdoret termi *interes i fëmijës* por *mirërritje e fëmijës*) që mund të konstatojmë se qëllimi i të gjithë legjislacioneve familjare mbi adoptimin e fëmijëve është garantimi i Interesit më të lartë të fëmijës, varësisht se cilin term e përdorin, etj.

¹⁴ Konventa mbi të drejtat e fëmijës (viti 1989) Neni 21, Konventa e Hagës për mbrojtjen e fëmijëve dhe bashkëpunimin për adoptimin ndërkombëtar (viti 1993) neni 1 al.1, neni 4 al.2; Konventa Evropiane për adoptimin e fëmijëve (1967) neni 8 al.1, Konventa evropiane për adoptim (viti 2008) neni 4, si dhe dokumentet tjera në nivel ndërkombëtar të cilat rregullojnë adoptimin.

shumica e fëmijëve do të kishin në prioritet realizimin e interesit material dhe sigurimin e jetës së tyre, mirëpo pas sigurimit të materiales gjithsesi, është edhe plotësimi i shpirtërores dhe zëvendësim i familjes së origjinës. Në shtetin tonë në të shumtën e rasteve, për shkak të gjendjes së vështirë ekonomike me të cilën përballen çiftet e reja, janë të detyruar që pa dëshirën e tyre t'i lënë fëmijët nëpër jetimore, e që është edhe më e prekshme braktisja në rrugë e foshnjës së porsa lindur nga vajzat e reja të cilat nuk kanë rrugëdalje tjetër. Në këto, dhe situata tjera të ngjashme, shteti duhet të ndërmerr masa adekuate dhe specifike për parandalimin e këtyre rasteve.

Dukuri shumë e përhapur në shoqërinë shqiptare të RM-së është edhe marrja e fëmijëve 'në shpirt' nga anëtarët e familjes më të ngushtë, regjistrojnë fëmijën si të vetin dhe i fshehin të vërtetën rreth prejardhjes dhe prindërve biologjik. Këto raste, fatkeqësisht, janë të shumta, edhe atë me të vetmen arsye- mos shprehja e dëshirës për të adoptuar fëmijë prindërit e të cilëve nuk dihen, fëmijë të etnitetit dhe fesë tjetër. Në të shumtën e rasteve, merren dhe jepen fëmijë menjëherë pas lindjes, në mënyrë që fëmija më lehtë të pranoj dashurinë e prindërve të ri, mirëpo gjithnjë duke e rritur nën frymën e gënjeshtres. Zbulimi i të vërtetës, se ky fëmijë nuk është i lindur nga njerëzit me të cilët ka jetuar, ndikon shumë negativisht në jetën e tij/saj, zakonisht ndryshon sjelljen, duke mos arsyetuar veprimin e prindërve që e kanë lindur. Në raste shumë të rralla këto fëmijë e pranojnë në mënyrë të qetë faktin se janë të dhënë 'në shpirt'.

B.S (23 vjeçar) Kur kam kuptuar se tezja ime është nëna ime e vërtetë, kam urrejtur çdo njeri të familjes. Të vërtetën rreth dhënies sime 'në shpirt' ma ka komunikuar djali i tezes (vëllai im). Kam kuptuar këtë fakt në moshën 18 vjeçare, dhe kanë qenë momentet më të tmerrshme të jetës sime, tani vazhdoj dhe jetoj duke mos e arsyetuar veprimin që e kanë bërë prindërit e mi biologjik, edhe pse njerëzit që i njoh si nënë dhe baba më kanë ofruar dashurinë më të madhe në botë, mirëpo jam kundër këtij veprimi. Tezja, në fakt është nëna ime.

Me anë të adoptimit plotësohen edhe interesat e adoptuesit (adoptuesve) në aspektin biologjik dhe emotiv, në kuptimin e plotësimit të nevojës së tij (tyre) të kenë fëmijë, të jetë prind, por edhe eventualisht, në pleqëri të ketë kush të kujdeset për të, t'i jep përkrahje morale, të ndihmoj, ta dërgoj tek mjeku, ta vendos në institucionet për banim, dhe të ngjashme. Nëse prindërit e fëmijës janë gjallë dhe të njohur, interesi i tyre

është që me anë të adoptimit të arrihen kushte për përkujdesjen dhe zhvillimin e fëmijës, të cilët ata vetë nuk mund t'ia ofrojnë, respektivisht, ata që janë të ngarkuar me përkujdesjen e fëmijës, p.sh nëna vetushqyese, nuk janë në gjendje as edhe për vete të sigurojnë kushte materiale për ekzistencë, e aq më pak për fëmijën. Edhe pse adoptimi, në prioritet i vë interesat e fëmijës, nëse i realizon të gjitha këto interesa, do të arrijë plotësimin e qëllimit shoqëror- përkujdesjen e fëmijës, në periudhën kur ai ka më tepër nevojë për kujdes, dashuri dhe mirëritje nga ana e prindërve në një mjedis me harmoni familjare .¹⁵

Nuk do ti jepet në adoptimi fëmija personit të cilit:

- a) i është marrë apo kufizuar e drejta prindërore, si dhe personit të cilit i është shqiptuar dënimi për kryerje të veprës penale me dënim burg efektiv me kohëzgjatje mbi gjashtë (6) muaj,
- b) i është kufizuar apo marr zotësia e veprimit,
- c) për të cilin ekziston dyshim i bazuar se pozitën e adoptuesit do ta shfrytëzoj në dëm të të adoptuarit,
- ç) i cili ka sëmundje shpirtërore apo ka pengesa në zhvillimin intelektual, si dhe personi i cili vuan nga sëmundja e cila do të mund ta sillte në rrezik shëndetin dhe jetën e të adoptuarit,
- d) pengesa fizike e të cilit është e asaj shkalle për të cilën në mënyrë të arsyeshme mund të dyshohet në mundësinë e tij në ushtrimin e kujdesit ndaj të adoptuarit,
- dh) i cili është më i vjetër se 45 vjet,
- e) i cili është i varur nga droga apo substanca psikotropike apo alkooli,
- ë) i cili ka sëmundje të rëndë kronike apo është i sëmurë nga sëmundje jo të shërueshme ngjithëse dhe
- f) nëse mendimi i ekipit profesional i Qendrës për punë sociale është negativ lidhur me mundësinë që ato persona të jenë prindër (neni 122, LF).

¹⁵ Kiril Cavgar, *Komentari na Zakonot za semejstvoto*, Shkup, 1998, fq.203-204 (përkthim: Komentim i Ligjit mbi Familjen)

Çështje tjetër lidhur për të cilën duhet të parashihen masa ligjore është edhe situata e adoptimit nga ana e fëmijëve të mitur të cilët kanë fituar zotësinë për të vepruar para moshës 18 vjeçare me anë të emancipimit (pra me lidhjen e martesës).¹⁶

Në hipotezën se nëse fëmija i mitur ka lidhur martesë me leje të gjykatës, gjegjësisht në bazë të vendimit gjyqësor ka fituar zotësinë e plotë për të vepruar para arritjes së moshës madhore, në këtë rast adoptimi nuk është i lejuar.¹⁷ Pajtohem me konstatim e dhënë nga profesoresha Marija Draškić, sepse, mosha e këtyre fëmijëve të martuar nuk është e mjaftueshme që ata të jenë në gjendje të shprehin gatishmërinë e tyre për një përgjegjësi dhe kujdes që kërkon adoptimi i një fëmije.

- ***Roli i Komisionit gjatë zhvillimit të procedurës për themelimin e adoptimit***

Adoptimi themelohet para Komisionit të formuar nga Ministri për punë dhe politikë sociale në pajtueshmëri me dispozitat ligjore. Komisioni luan rol të rëndësishëm prej momentit të shqyrtimit të kërkesës së paraqitur nga adoptuesit potencial e deri në sjelljen e vendimit përfundimtar për adoptim. Komisioni përbëhet prej një personeli me persona të kualifikuar me përvojë prej 15 viteve në fushën e adoptimit, edhe atë: jurist, punëtor social, psikolog dhe pedagog.¹⁸

Duke u dhënë prioritet, marrëdhënieve që themelohen midis të rriturve dhe fëmijëve veçanërisht kur është fjala për adoptimin e plotë, dhe nevojës për vendosjen e marrëdhënieve harmonike dhe të përbashkëta në familje, është i patjetërsueshëm zbatimi i procedurës për ndjekjen e periudhës së adaptimit (përshtatshmërisë) para se të themelohet adoptimi. Mirëpo, duhet pasur parasysh se ky kontrollim duhet të realizohet vetëm atëherë kur do të zbatohen të gjitha metodat e rëndësishme profesionale dhe të sigurohen të gjitha parakushtet e operacionalizuara, kushtet për zbatimin e formës së adoptimit për

¹⁶ Shin nenin 18 al.2 të Ligji mbi familjen Gazeta Zyrtare nr. 83/2004 (Gjkata kompetente në procedurë jashtëkontestimore, mund, t'i lejojë lidhjen e martesës personit i cili ka mbush 16 vjet, nëse vërtetohet se personi ka arritur pjekuri fizike dhe psikike të duhur për kryerjen e të drejtave dhe detyrimeve të cilët rrjedhin nga martesa, paraprakisht duke marrë mendim nga institucioni shëndetësor dhe ndihmë profesionale të vërtetuar nga qendra për punë sociale) . Pra, emancipimi nënkupton fitimin e zotësisë për të vepruar para arritjes së moshës madhore.

¹⁷ Marija Draškić, *Porodično pravo i pravo deteta*, Beograd, 2005, fq 230

¹⁸ Neni 113 Ligji mbi familjen Gazeta Zyrtare nr. 83/2004

pjesëmarrësit konkret në procedurë, si dhe sjellja e përfundimeve ekipore për ekzistimin e komplementaritetit të përshtatshmërisë midis adoptuesve potencial, nevojave dhe karakteristikave të fëmijës. Me fjalë tjera, është e nevojshme që në praktikë të zbatohet dhe vërtetohet komplementariteti i përshtatshmërisë.¹⁹

Në nenin 6 të Ligjit për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit mbi familjen Gazeta Zyrtare e RM-së nr. 33/2006, periudha e adaptimit respektivisht kontrollimit të familjes së adoptuesit nga ana e Komisionit kompetent për vendosjen e fëmijës në adoptim, nga gjashtë (6) deri në nëntë (9) muaj është shkurtuar në dy (2) deri në tre (3) muaj. Është periudhë shumë e shkurtër për të kontrolluar përshtatjen e fëmijës në një familje të re. Mirëpo, Komisioni duhet të ketë kujdes të veçantë dhe të mbaj kontakte të vazhdueshme me adoptuesit për të kontrolluar se a është realizuar interesi i fëmijës dhe adoptuesit a ushtrojnë statusin prindëror në mënyrë kualitative duke i plotësuar obligimet e tyre ligjore në përputhje me nevojat dhe kërkesat të fëmijës. Theks i veçantë vendoset në lidhjet emocionale të krijuara midis adoptuesve të mundshëm dhe fëmijës, kualitetit të kujdesit ndaj fëmijës si dhe kualitetit të pranimit të rolit të prindërit. Ndjekja realizohet duke vizituar familjen (më së paku një (1) herë në muaj në periudha të ndryshme të ditës që të mund të mbikëqyrret kryerja e aktiviteteve të ndryshme ndaj fëmijës). Para së gjithash, bisedohet me adoptuesit dhe me fëmijën nëse është në një moshë më të rritur, mbikëqyrin fëmijën dhe zhvillimin e tij, bisedohet me anëtarët tjerë të familjes, kushërinjtë, shoqërinë etj. Gjatë vizitave mund edhe të ofrohet ndihmë profesionale për ushtrimin e të drejtës prindërore. Për ndjekjen e kësaj periudhe janë përgatitur formularë të veçantë me udhëzime për plotësimin e tyre.²⁰

Edhe periudha e adaptimit të fëmijës si dhe metodat që shfrytëzohen gjatë kësaj mbikëqyrje, janë në kuadër të masave juridike për mbrojtjen e interesit të fëmijës që adoptohet, zbatimi i të cilëve ndikon në efikasitetin e procedurës për adoptim, e cila, në esencë, është shumë e lodhshme si për fëmijët ashtu edhe për prindërit-adoptues.

¹⁹ *Strucno-metodolosko upatstvo za sproveduvanje na posvojuvanjeto*, JU Zavod za socijalni dejnosti, Shkup, 1999, fq.44 (përkthim: Udhëzim profesionalo- metodologjik për realizimin e adoptimit, Enti për shërbime sociale)

²⁰ *Strucno – metodoloski upatstva i priracnici, Dokumenti-* kniga 1, tom 2, JU Zavod za Socijalni dejnosti, Shkup 2007, fq. 24 (përkthim:Udhëzime profesionale- metodologjike dhe doracak, Dokumente, Libri 1 vëllimi 2, Enti për punë sociale)

Konventa Evropiane për adoptimin e fëmijëve e vitit 1967 parasheh periudhën adaptive, mirëpo duke mos përcaktuar kohëzgjatje,²¹ ndërkaq Konventa evropiane për adoptim (viti 2008), u lë hapësirë shteteve kontraktuese që në ligjet e tyre nacionale të përcaktojnë periudhën e adaptimit në familjen e adoptuesit, por çdo herë duke e përcaktuar në pajtueshmëri me interesin e fëmijës.²²

Marrja e vendimit për adoptim filtrohet në një procedurë ligjore (nenet 124-143 LF). Pas kalimit të afatit ligjor për adaptimin e fëmijës në familjen e re, Komisioni pasi merr raportin dhe mendimin pozitiv për periudhën adaptive nga Qendra për punë dhe politikë sociale në afat prej 30 ditëve inicon procedurën dhe me plotësimin e të gjitha parakushteve ligjore sjell vendim për themelimin e adoptimit (neni 136, LF). Ndërsa, në afat prej 15 ditëve vendimin ia dorëzon ofiqarit për regjistrimin në librin amë të të lindurve (neni 143, LF) .

Në rast të përpilimit të një Ligji të ri për mbrojtjen e fëmijëve pa prindër dhe pa përkujdesje prindërore, duhet të parashihen mekanizma sigurie në aspektin e ndjekjes se si fëmija është përshtatur në familjen e re, ndërsa për adoptuesit duhet të formohet një institucion ku do të mund të drejtohen për ndihmë dhe këshilla se si të veprojnë në rastet konkrete lidhur me fëmijën e adoptuar.

Komisioni për themelimin e adoptimit gjatë vitit 2007 ka kryer:

- 98 regjistrime të adoptuesve në regjistrin për adoptues të mundshëm,
- 90 regjistrime të fëmijëve të mitur në regjistrin për të adoptuar të mundshëm,
- 60 adoptime të fëmijëve të mitur, prej të cilëve:
 - 51 raste të adoptimit të plotë të fëmijëve nga ana e adoptuesve shtetas të RM-së,
 - 7 raste të adoptimit të plotë të fëmijëve nga ana e adoptuesve shtetas të huaj,
 - 1 rast të adoptimit të plotë të fëmijëve nga ana e një çifti prej të cilëve njëri është shtetas i RM-së, tjetri shtetas i huaj, mirëpo jetojnë në territorin e RM-së,

²¹ Shih nenin 17 të Konventës evropiane për adoptimin e fëmijëve, viti 1967

²² Shih nenin 19 të Konventës evropiane për adoptim, viti 2008

- 1 adoptim jo të plotë të fëmijës së mitur.²³

Komisioni për vendosjen e fëmijës në adoptim pranë Ministrisë për punë dhe politikë sociale, punën dhe procedurën e adoptimit e bazon në parimet e poshtëshënuara:

- PARIMI I HUMANITETIT- Qendra për punë dhe politikë sociale dhe Komisioni janë të obliguar maksimalisht të respektojnë dinjitetin e të gjithë pjesëmarrësve në procedurë.
- PARIMI I DINAMIKËS- Qendra për punë dhe politikë sociale dhe Komisioni duhet të mbajnë llogari që zgjedhja e formës së mbrojtjes së fëmijës të jetë në pajtueshmëri me moshën dhe me nevojat e tij.
- PARIMI I SË VËRTETËS- Nënkupton që njoftimi lidhur me të vërtetën sa i përket adoptimit të bëhet në mënyrën dhe moshën sa më të përshtatshme për fëmijën. Tregimi i të vërtetës nga njëra anë është më se i nevojshëm për zhvillimin e shëndoshë të fëmijës si dhe për tejkalimin e mosbesimit të fëmijës ndaj adoptuesve, dhe nga ana tjetër ndikon në heqjen e barrës adoptuesve për fshehjen e së vërtetës rreth adoptimit.²⁴

Pas themelimit të adoptimit në librin amë të të lindurve, si prindër të fëmijës shënohen adoptuesit, kurse si vend i lindjes së fëmijës shënohet vendi të cilin me marrëveshje do ta përcaktojnë adoptuesit dhe Komisioni. Ofiqari është i obliguar të kryejë regjistrim të ri në librin amë të të lindurve dhe për atë t'u jep adoptuesve çertifikatë nga libri amëz i të lindurve (neni 142, LF). Kështu veprohet vetëm në rast të adoptimit të plotë, në rast të adoptimit jo të plotë në librin amë të të lindurve regjistrohet fakti i adoptimit.²⁵ Me anë të kësaj norme kogente zyrtarisht bëhet shlyerja e identitet të fëmijës dhe zhdukja e prejardhjes së tij, duke e regjistruar si fëmijë të adoptuesit/ve.

Adoptimi i plotfuqishëm prodhon efektet e caktuara, vëllimi i të cilëve dallon varësisht se a është themeluar adoptimi i plotë apo jo i plotë, edhe atë:

- Të drejtat dhe detyrat e adoptuesit ndaj të adoptuarit
- Të drejtat dhe detyrat e të adoptuarit ndaj adoptuesit

²³ Raporti i Ministrisë për punë dhe politikë sociale 'Socijalna slika na Republika Makedonija', Shkup, 2008 (përkthim: 'Pasqyra sociale në Republikën e Maqedonisë')

²⁴ *Strucno – metodoloski upatstva i priracnici, Dokumenti- kniga 1, tom 2, JU Zavod za Socijalni dejnosti, Shkup 2007, fq. 9-10.*

²⁵ Kiril Cavgar, *Komentar na Zakonot za semejstvoto*, Shkup, 1998, fq.226

- Efektet lidhur me emrin e të adoptuarit
- Efektet juridiko familjare:
 - a) Të drejtat prindërore
 - b) Gjinia e adoptimit
 - c) Adoptimin si pengesë martesore
 - ç) Adoptimi si bazë për dhënien e ushqimisë
- Të drejtat trashëgimore në rast të adoptimit

- ***Fëmijës duhet komunikuar faktin se është i adoptuar***

Fëmija i cili është më i vjetër se dymbëdhjetë (12) vjet, ka të drejtë të jep pëlqimin për adoptimin e tij,²⁶ andaj ai ka të njohur faktin rreth adoptimit, mirëpo kur adoptohet fëmija më i vogël, në këtë rast, ai ka të drejtën e njohjes së vërtetës rreth prejardhjes së tij dhe njohjen e prindërve biologjik.²⁷ Sipas nenit 22 al.3 të Konventës evropiane për adoptim (viti 2008)- Fëmija i adoptuar duhet të ketë qasje deri tek të dhënat e regjistruara nga organet kompetente sa i përket informimit të tij për prindërit e vërtetë. Prindërit biologjik kanë të drejtë që mos të zbulojnë identitetin e tyre, por organi kompetent, në pajtueshmëri me dispozitat ligjore, mund të vendosë që këtë të drejtë të tejkalojë dhe duke marrë parasysh rrethanat që kanë të bëjnë me të drejtat e fëmijës dhe prindërve, të zbulojë identitetin e prindërve.

Kjo dispozitë e garantuar me konventa ndërkombëtare, respektivisht parimi i komunikimit të së vërtetës rreth prejardhjes së fëmijës nuk është i inkorporuar në dispozitat ligjore të vendit tonë. Prindërit-adoptues, nuk kanë obligim ligjor që fëmijës t'ia komunikojnë të vërtetën rreth adoptimit dhe rreth familjes së vërtetë të tij. Fëmija i adoptuar të vërtetën rreth statusit të tij kur do që të jetë e kupton, mirëpo nga vet adoptuesit duhet të përgatiten rrethanat, duhet përshtatur kohën e komunikimit të së vërtetës. Gjithsesi, këtu luan rol të rëndësishëm mosha e fëmijës, atë se kur ai në mënyrën më të qetë do të jetë i përgatitur të pranojë të vërtetën. Assesi, nuk duhet lejuar që fëmija,

²⁶ Neni 123, al.1 LF

²⁷ Njohja e prindërve biologjik garantohet me Neni 7 të Konventës mbi të drejtat e fëmijës, viti 1989

të vërtetën rreth ardhjes në familjen e re ta kuptojë nga personat tjerë, sepse ajo ndikon negativisht në edukimin dhe sjelljen e tij, e deri në braktisjen e shtëpisë së adoptuesve. Në një familje të shëndoshë nuk duhet të ekzistojë gënjeshtria e as fakti se fëmija është i adoptuar. Me komunikimin e së vërtetës edhe adoptuesit lirohen nga një barrë e rëndë, si dhe nëpërmjet shfaqjes së sinçeritetit shprehin dashurinë dhe qëndrimin serioz se sa vlerë për ato ka ai fëmijë. Ikja nga e vërteta është një gabim, sepse ndërtimi i bindjes se atë fëmijë e kanë lindur shkatërron lidhjet emocionale deri atëherë të krijuara.

Aplikimi i masave sociale për mbrojtjen e fëmijëve pa prindër dhe pa përkujdesje prindërore

Kushtetuta e RM-së proklamon obligimin e shtetit për mbrojtjen e fëmijëve (neni 42 al.1) dhe veçanërisht mbrojtjen e fëmijëve pa prindër dhe pa përkujdesje prindërore (neni 40 al.4).

Gjithsesi, adoptimi është masë juridike më e përshtatshme për mbrojtjen e fëmijëve pa prindër dhe pa përkujdesje prindërore, mirëpo jo çdo fëmijë i kategorisë së lartpërmendur ka fatin që të adoptohet, andaj shteti me mekanizmat e veta duhet të ofrojë mundësi tjetër për t'u ndihmuar këtyre fëmijëve.

Ministria për punë dhe politikë sociale e RM-së, nën korniza të programit *Mbrojta Sociale*, fëmijëve pa prindër dhe pa përkujdesje prindërore u ofron këto forma të mbrojtjes:

- *të drejtën e vendosjes në institucionet (jetimore) për përkujdesje sociale- u ndihmon fëmijëve që të përgatiten për jetë të pavarur dhe për inkuadrimin në marrëdhënie pune. Masat juridike që aplikohen në kuadër të këtyre institucioneve mbrojtëse janë: sigurimi i banimit, ushqimi, veshja, përkujdesja, ndjekja e shkollës fillore dhe të mesme, organizimi i ndihmës profesionale për zotërimin e suksesshëm të programeve edukativo-arsimore, organizimi i formave të ndryshme*

të punës dhe jetës së këtyre fëmijëve si dhe përkujdesi për shëndetin e tyre. Këtë të drejtë, fëmijët pa prindër dhe pa përkujdesje prindërore e gëzojnë deri në mbarimin e shkollës së mesme.

Alternativë tjetër për t'u ndihmuar këtyre fëmijëve është *Vendosja në familje tjetër*,²⁸ kjo e drejtë iu njihet deri në mbarimin e shkollës së mesme.

- *të drejtën në mbrojtje shëndetësore,*
- *të drejtën në ndihmë financiare-* për fëmijët të cilët deri në arritjen e moshës 18 vjeçare kanë gëzuar statusin e fëmijës pa prindër dhe pa përkujdesje prindërore dhe i cili fëmijë nuk ka asnjë burim financiar. Kjo ndihmë financiare këtyre fëmijëve u jepet deri në arritjen e moshës 26 vjeçare, sepse llogaritet se pas arritjes së kësaj moshe ai fëmijë, tani më i rritur, është i aftë të inkuadrohet në marrëdhënie pune dhe të sigurojë të ardhura materiale. Lartësia e ndihmës financiare është 25%, por nëse fëmija është në ndjekje të shkollimit atëherë ndihma financiare është 35% nga rroga mesatare mujore për punëtor në RM. E drejta në ndihmë financiare ka filluar të realizohet nga muaji Tetor i vitit 2005. Gjatë vitit 2006 dhe 2007, çdo muaj, mesatarisht këtë të drejtë e kanë realizuar afër 90 shfrytëzues.²⁹
- Fëmijët pa prindër dhe pa përkujdesje prindërore gëzojnë edhe *të drejtën e shfrytëzimit të penzionit familjar* nëse janë nën përkujdesjen e personit të siguruar, këtë të drejtë e gëzon edhe fëmija i adoptuar nga ana e personit të siguruar si dhe prindërit-adoptuesit të përkujdesur nga ana e personit të siguruar (neni 70- al.2,3 i Ligjit mbi sigurimin penzional dhe invalidor, Gazeta Zyrtare e RM-së nr.80/1993). Mirëpo, këtë të drejtë personat e lartpërmendur mund ta gëzojnë vetëm nëse personi i siguruar, respektivisht shfrytëzuesi i penzionit, nuk ka anëtar

²⁸ *Formi, merki i ushtrisë na socijalnata zastita*, 2007, br. 2.1.8.4, Drzaven zavod za statistika, Shkup, 30.05.2008 (përkthim: Format, masat dhe shërbimet e mbrojtjes sociale, 2007, nr. 2.1.8.4, Enti Shtetëror për statistikë, Shkup, 30.05.2008) - Gjatë vitit 2007 janë vendosur në familje tjetër gjithsej 324 fëmijë, prej të cilëve 247 janë larguar nga familja për shkak të problemeve familjare, 1 për shkak të devijimeve në personalitet dhe sjellje, 31 fëmijë për shkak të pengesave psikike, 8 fëmijë për shkak të pengesave fizike, dhe 37 fëmijë për shkaqe tjera.

²⁹ Marrë nga raporti i Ministrisë për punë dhe politikë sociale 'Pasqyra sociale në Republikën e Maqedonisë', Shkup, 2008

tjetër të familjes më të ngushtë ose vetëm nëse pjesa e penzionit për anëtar më të ngushtë të familjes nuk e rrezikon shumën që u takon atyre.

- Në Shkup funksionojnë 4 (katër) qendra ditore, ku fëmijëve që jetojnë në rrugë u ofrohet ushqim, veshmbathje, sigurim shëndetësor, edukim, motivim për ndjekjen e sistemit arsimor, organizim të aktiviteteve kulturore, zbatim të aktiviteteve tjera të rëndësishme për inkuadrim në jetën shoqërore.

Komunat, qyteti i Shkupit, dhe komunat në qytetin e Shkupit mund të sigurojnë zbatimin e mbrojtjes sociale të personave me pengesa fizike, fëmijëve pa prindër dhe fëmijëve pa mbrojtje prindërore, fëmijëve me nevoja të veçanta, fëmijëve nga rruga, fëmijëve me probleme arsimore dhe sociale, fëmijëve nga familjet me prindër vetushqyes, personave të nënshtruar rrezikut social, personave të cilët keqpërdorin alkoolin dhe drogën dhe personave më të moshuar pa përkujdesje familjare në formë të mbrojtjes institucionale dhe jashtë institucionale, banim për personat e rrezikuar dhe ngritjen e vetëdijes te popullata për nevojën e sigurimit të mbrojtjes sociale (neni 6 i Ligjit mbi mbrojtjen sociale, Gazeta Zyrtare nr.21/2006).

Mirëpo, realiteti është krejt ndryshe nga ajo që garantohet me Ligj, nëpër rrugë të qyteteve çdo ditë hasim fëmijë të cilët nuk kanë përkrahjen nga asnjë, e aq më pak nga ana e institucioneve publike, sikur çështja e humanitetit nuk ka vend në shtetin dhe shoqërinë tonë. Shumë pak u ofrohet ndihmë fëmijëve të lënë pas dore.

Në qytetin e Shkupit, ka mbi 1000 fëmijë të cilët fëmijërinë e tyre e kalojnë në rrugë, nën qiellin e hapur dhe pa përkujdesje prindërore. Ky numër, në gjithë Maqedoninë, arrin numrin afër 2000. Sipas anketave dhe hulumtimeve të deritanishme, afër 30 % e fëmijëve që jetojnë në rrugë janë fëmijë pa prindër, por ka edhe fëmijë me një prind, apo me prindër të shkurorëzuar, ose fëmijë me probleme familjare. Këto fëmijë janë të moshave dhe nacionaliteteve të ndryshme, por përqindja më e madhe, rreth 58 % janë të nacionalitetit rom. Brengosë fakti se 15,5 % e fëmijëve në rrugë janë të moshës parashkollore, 64 % të moshës prej 7 deri më 14 vjet.³⁰

Dukuri shumë e përhapur, është abuzimi i këtyre fëmijëve, duke i eksploatuar në mënyra të ndryshme çnjerëzore. Shndërrimi i këtyre fëmijëve në lypsar, keqpërdorimi për punë të

³⁰ Ambasada e parë e fëmijëve në botë Megjashi, të dhënat gjenden edhe në: www.childrensembassy.org.mk.

rënda fizike, trafikimi i tyre për prostitucion, qëllime pornografike dhe trafikim i organeve të tyre. Rastet e tyre nuk bëhen publike sepse për këto fëmijë nuk kujdeset asnjë person i cili do të mund të paraqet dyshimin për keqpërdorim deri te organet kompetente.

Nga të dhënat e Entit shtetëror për statistikë gjatë vitit 2007, si formë e mbrojtjes sociale është realizuar **adoptimi** në 47 raste (47 fëmijë janë dhënë në adoptim), prej të cilëve 38 fëmijë që janë larguar nga familja për shkak të problemeve familjare, kurse 9 fëmijë tjerë për shkaqe tjera.³¹

Niveli i rëndësië së institucionit të adoptimit në Republikën e Maqedonisë

Duke mos i kushtuar kujdes të mjaftueshëm adoptimit si formë më e përshtatshme për mbrojtjen e fëmijëve pa prindër dhe pa përkujdesje prindërore, në shtetin tonë kemi pasqyrimin e problemeve të kategorive të ndryshme:

- ***Margjinalizimi dhe mosnjohja e mjaftueshme e institucionit të adoptimit:***

Në Republikën e Maqedonisë ende nuk ekziston një iniciativë që adoptimi të studiohet në aspektin kërkimor-shkencor. Pjesa më e madhe e popullatës sonë nuk kanë të qartë rëndësinë e këtij institucioni, llojet, kushtet për adoptim, procedurën dhe ushtrimin e të drejtës prindërore të themeluar me adoptim, pra nuk kanë të njohur kornizën ligjore ku paraqiten të drejtat dhe detyrimet e personave që themelojnë familjen me anë të adoptimit. Që është edhe më ekstreme, disa edhe nuk kanë të njohur fare mundësinë që me anë të adoptimit mund të plotësohet nevoja për të pasur fëmijë, ndërsa ato që kanë njohuri keqkuptojnë adoptimin e fëmijës. Zakonisht, më i përhapur dhe më i njohur në shoqëri është procesi i fekondimit (mbarësimit) artificial, dhe marrja e fëmijës ‘në shpirt’ nga personat në gjini të gjakut duke i dhënë fuqi botëkuptimit të fshehjes së prejardhjes së vërtetë të fëmijës.

³¹ Formi, merki i usluga na socijalnata zastita, 2007, br. 2.1.8.4, Drzaven zavod za statistika, Shkup, 30.05.2008.

- ***Mungesa e të dhënave zyrtare:***

Ekzistimi i dispozitës ligjore në Ligjin mbi familjen të RM-së, se: ‘Të dhënat për adoptimet e themeluara janë sekrete zyrtare’ (neni 155) pamundëson qasjen për hulumtimin empirik të këtij institucioni të një rëndësie shumëdimensionale (për fëmijën që adoptohet, adoptuesin, shoqërinë dhe prindërit biologjik të cilët nuk kanë mundësi materiale të kujdesen për fëmijën). Në Entin shtetëror statistikor të RM ende nuk ekziston një raport zyrtar ekskluzivisht vetëm për adoptimin. Qendrat për punë dhe politikë sociale mundohen deri në maksimum të mos shfaqin numrin e saktë të fëmijëve të adoptuar, sepse shumica e prindërve-adoptues dhe prindërve biologjik dëshirojnë fshehjen e këtij fakti, pra kemi një jotransparencë të organeve shtetërore.

Andaj, në prioritet të politikave të mbrojtjes sociale dhe të shkencës mbi të drejtën familjare të vendit duhet të vendosen fëmijët në përgjithësi dhe në veçanti fëmijët pa përkujdesje, të cilët kanë nevojë për mbrojtje dhe vëmendje të veçante nga familja dhe institucionet shtetërore.

- ***Numri i pamjaftueshëm i institucioneve për shërbime sociale të fëmijëve jashtë kujdesit prindëror:***

Në Republikën e Maqedonisë ekzistojnë tre (3) Institucione publike për strehimin e fëmijëve pa prindër dhe pa përkujdesje prindërore.

Shtëpia (jetimorja) për përkujdesjen e fëmijëve prej 0 deri në 3 vjeç në Manastir ka kapacitet prej 120 shtretërve, ku për momentin janë të vendosur 98 fëmijë. Në shtëpinë për fëmijë pa prindër ‘11 Tetori’ në Shkup strehohen fëmijët në moshën mbi tre vjeçare deri në mbarimin e shkollës së mesme, respektivisht më së voni 6 muaj pas mbarimit të shkollës së mesme, pra deri në mëvetësimin e tyre për punë. Në këtë jetimore janë vendosur afër 88 fëmijë.

Këto institucione i ngjajnë më shumë një strehimoreje ku fëmijët sigurojnë vetëm kushtet elementare për të mbijetuar (kalojnë ditën, sigurojnë ushqimin dhe fjetjen, dhe deri diku u

ofrohet edhe përkujdesi shëndetësor), mirëpo këto institucione fare pak ndikojnë në zhvillimin e tyre psikosocial dhe integrimin e tyre në shoqëri.

Përveç këtyre institucioneve, funksionon edhe institucioni për mbrojtje sociale SOS 'Fshati i fëmijëve', ku për momentin janë të strehuar 84 fëmijë pa prindër dhe pa përkujdesje prindërore.³²

Më datën 20 Nëntor 2008, është hapur edhe një jetimore e vogël në qytetin e Berovës. Funksionimi i kësaj jetimore është bërë në kuadër të projektit të përbashkët të Ministrisë për punë dhe politikë sociale të RM-së dhe UNICEF-it. Për momentin në këtë jetimore janë të vendosur 5 fëmijë të moshës prej 5-12 vjeçare.

Ofrimi i këtyre shërbimeve sociale për strehimin e fëmijëve deri në vendosjen e tyre në adoptim, caktimin e kujdestarit apo vendosjen e tyre në familje tjetër është centralizuar vetëm në qytetin e Shkupit, përveç institucionit që gjendet në Manastir dhe Berovë, duke mos mbajtur llogari për qytetet tjera.

Krahasuar këtë numër të fëmijëve të vendosur nëpër këto jetimore me numrin rreth 2000 të fëmijëve të cilët bredhin për çdo ditë rrugëve duke lutur për lëmoshë dhe duke mos patur se ku të strehohen, mund lirisht të konkludojmë se shteti ynë dhe shërbimet sociale publike fare pak ose aspak nuk kanë bregën e këtyre fëmijëve. Mos ofrimi i shërbimeve sociale adekuate dhe të mjaftueshme ndikon në nivelin e rritjes së delikuencës së të miturve dhe ushtrimin e veprimeve kriminale ndaj këtyre fëmijëve.

Në Republikën e Maqedonisë është më se e nevojshme hapja dhe funksionimi i Agjencionit për ndërmjetësim rreth adoptimit, duke pasur rolin e organizatës jofitimprurëse, e licencuar dhe miratuar nga organet kompetente të vendit, veprimtaria e të cilës do të rregullohet me ligj, mirëpo procedura ligjore e adoptimit duhet vazhduar të zhvillohet dhe përfundohet nga Komisioni në kuadër të Ministrisë për punë dhe politikë sociale.

Veçanërisht roli i këtyre agjencioneve do të vinte në shprehje në ndërmjetësimin rreth adoptimit ndërkombëtar.³³

³² Marrë më 23.07.2008 në: <http://www.soschildrevillages.org.uk/sponsor-a-child/european-child-sponsorship/macedonia.htm>

³³ Funksionimi i agjencioneve të tilla si organe të akredituara dhe nën mbikëqyrjen e organeve kompetente të shteteve që bashkëpunojnë në çështjen e adoptimit të fëmijëve parashihet edhe me Konventën e Hagës për mbrojtjen e fëmijëve dhe bashkëpunimin për adoptimin ndërkombëtar (viti 1993), gjithashtu

- ***Mos efikasiteti i procedurës për vendosjen e fëmijës në adoptim:***

Edhe pse Ligji mbi familjen të RM-së parasheh respektim të afateve ligjore gjatë gjithë procedurës të vendosjes së fëmijës në adoptim, situata është krejt ndryshe kur vërehet nga këndvështrimi i personave të cilët kanë aplikuar për të adoptuar fëmijë.

Para katër viteve kemi paraqitur dokumentacionin e nevojshëm për adoptim të fëmijës, por prej atëherë lënda jonë bartet prej një institucioni në institucion tjetër, dhe nuk kemi asnjë përgjigje lidhur me rastin tonë. Vetëm për dokumentacion, deri më tani kemi shpenzuar mbi 1.000 euro, pasi çdo vit duhet të nxjerren të reja. Nga institucionet shtetërore i kemi kaluar të gjitha procedurat për vërtetim të përshtatshmërisë, por tani më jemi moshuar duke pritur përgjigjen lidhur me atë se a i plotësojmë kushtet për fëmijë, pasi kemi kaluar kufirin e moshës prej 45 vjet për të adoptuar foshnjë. Gjithnjë na përgjigjen se janë duke punuar rreth rastiit tonë, andaj tani më kam filluar të bindem se për adoptimin e një fëmije janë të nevojshme lidhjet farefisnore dhe shoqërore. (1 mars 2008, shtypi ditor 'Utrinski Vesnik').

Në shtet, duke llogaritur në përqindje, për adoptimin e një fëmije pritet 3-4 vite, mirëpo ka edhe raste të tilla që adoptuesit potencial presin edhe 8 vite. Adoptohen 3-4 fëmijë në muaj, kurse për momentin për adoptim presin 14 fëmijë të shëndoshë dhe 32 fëmijë që lëngojnë nga ndonjë sëmundje. Institucionet që merren me këtë problematikë theksojnë se e kuptojnë padurimin e çifteve të reja për t'u bërë prindër, por nuk mund të ju ndihmojnë , pasi që në shtet nuk ka fëmijë. Më saktësisht, nuk ka fëmijë me status juridikisht të rregulluar, sepse prindërit e tyre nuk japin deklaratë për heqjen dorë nga fëmijët .³⁴

veprimtaria e këtyre agjencioneve rregullohet edhe me Ligji për procedurat e birësimit dhe Komitetit shqiptar të birësimit, Nr.9695, viti 2007, Konventën evropiane për adoptimin e fëmijëve (1967).

³⁴ 1 mars 2008, shtypi ditor 'Utrinski Vesnik'.

- *Përfshirja e pamjaftueshme e këtij institucioni në legjislacionin pozitiv të RM-së:*

Duke marrë parasysh rëndësinë e këtij institucioni, legjislacioni familjar në RM vetëm me disa nene e rregullon adoptimin (nenet 110-155),³⁵ andaj është më se i nevojshëm hartimi i një ligji të posaçëm për përkujdesjen ligjore të fëmijëve pa prindër dhe pa përkujdesje prindërore duke i kushtuar vëmendje të veçantë adoptimit si mbrojtje më e përshtatshme.

³⁵ Institucioni i adoptimit, për disa çështje të caktuara rregullohet edhe me: Ligjin mbi mbrojtjen sociale, Ligjin mbi trashëgiminë, Ligjin për emrin personal, Ligjin mbi evidencën amë, Ligjin mbi të drejtën ndërkombëtare private, Ligjin mbi shtetësinë.

Përfundim

Çdo fëmijë është i shtrenjtë. Secili është krijesë e Zotit.

Nënë Tereza

Fëmija është qenia më e dashur në një familje dhe shoqëri, pa dallim statusin e tyre. Ato duhet të kenë kujdesin, dashurinë dhe mirësjelljen nga çdo njeri e sidomos nga prindërit e tyre.

Adoptimi paraqet formë juridike dhe veprim human për t'u mundësuar fëmijëve pa prindër dhe pa përkujdesje prindërore rregullim ligjor të statusit të tyre familjar, sigurim material të jetës së tyre si dhe shprehje të dashurisë prindërore nga personat që janë të gatshëm të përballen me këtë sfidë.

Rregullimi në pikëpamje normativo-juridike i fenomeneve shoqërore është postulat i shtetit të së drejtës. Së këndejmi, Qeveria e Republikës së Maqedonisë është treguar shumë joserioze, sepse nuk parasheh rregullim juridik të mjaftueshëm për fëmijët pa prindër dhe pa përkujdesje prindërore dhe respektim të dispozitave ligjore për ndihmat materiale të këtyre fëmijëve. Duke u mbështetur në Ligjin mbi mbrojtjen e fëmijëve (Gazeta Zyrtare e RM-së, nr.98/2000)- Neni 2 -Mbrojta e fëmijëve është një veprimtari e organizuar e bazuar në të drejtat e fëmijëve, si dhe në të drejtat dhe obligimet e prindërve dhe shtetit për planifikimin familjar, sigurimin e kushteve dhe standardit jetësor që i përgjigjet zhvillimit fizik, psikik, emocional, moral dhe social të fëmijës dhe obligimeve të shtetit për krijimin e kushteve për zhvillimin e politikës humane, dhënien e ndihmës së caktuar materiale prindërve bazuar në mundësinë e shtetit për mbajtjen, rritjen, kujdesin, mbrojtjen e fëmijëve, organizimin dhe sigurimin e funksionimit të institucioneve dhe shërbimeve për mbrojtjen e fëmijëve. E gjithë kjo është një dispozitë qartë e shkruar, por shumë pak ose aspak e zbatuar.

Prindërit e ri, ndeshen me vështirësi materiale lidhur me lindjen, rritjen dhe arsimimin e fëmijëve të tyre, nuk kanë aspak përkrahje nga shteti, sepse çdo gjë duhet të sigurojnë nga burimet financiare vetanake, andaj kjo dukshëm ndikon në zvogëlimin e natalitetit në shoqërinë tonë.

Organet kompetente për vendosjen e fëmijës në adoptim duhet të kenë objektiva dhe praktika të qarta sa u përket përpjekjeve të tyre për realizimin e prioriteteve të fëmijëve që adoptohen. Në Republikën e Maqedonisë shumë pak është shtruar çështja e vendosjes së fëmijëve në familjen e adoptuesit, arsyet janë nga më të ndryshmet, ndër të cilat më e dukshme është: mos efikasiteti i procedurës për themelimin e adoptimit, mos aplikimi i dispozitave ligjore të parashikuara me ligjet nacionale si dhe mos realizimi i kushteve të nevojshme të parashikuara me Konventat ndërkombëtare në këtë materie .³⁶ Përvoja e deri tanishme ka treguar se dispozitat lidhur me adoptimin brenda kornizave Ligjit mbi familjen janë aplikuar për çdo fëmijë pa marrë parasysh prapavijën e tyre sociopsikologjike. Çdo fëmijë është botë në vete dhe çdo rast i adoptimit duhet t'i përshtatet karakterit dhe nevojave të fëmijës.

Iniciativa e parë e cila duhet të ndërmerret nga ana e Qeverisë së RM-së, është përpilimi i *lex speciales* sa i përket mbrojtjes juridike të fëmijëve pa prindër dhe pa përkujdesje prindërore, ku më detajisht do të përcaktohen të drejtat e këtyre fëmijëve, kompetenca e organeve për realizimin e këtyre të drejtave si dhe obligimet dhe të drejtat e personave që do të caktohen si përgjegjës për këto fëmijë, pra, me një veprim të tillë do të mund të përmyllet kapitulli i plotësimit të zbrazëtirave juridike dhe shoqërore në këtë sferë të së drejtës, ku në mënyrë gjithëpërfshirëse dhe specifike për çdo rast konkret do të zbatohen dispozita përkatëse. Ndërmarrja e këtyre veprimeve konkrete konsiderohet pjesë e reformave ligjore dhe realizimi me përgjegjësi i këtyre reformave do të përmirësoj dukshëm nivelin familjar dhe shoqëror të fëmijëve, duke i dhënë theks të veçantë adoptimit si masë më e përshtatshme për zvogëlimin e numrit të fëmijëve pa prindër dhe pa përkujdesje prindërore.

³⁶ Republika e Maqedonisë ka ratifikuar Konventën evropiane për adoptimin e fëmijëve më 24.01.2002 ndërsa ka hy në fuqi më 16.02.2002, ndërkaq nuk ka ratifikuar Konventën e Hagës për mbrojtjen e fëmijëve dhe bashkëpunimin për adoptimin ndërkombëtar

Bibliografia

I

- Arta Mandro-Bilalli, Vjollca Meçaj, Tefta Zaka, Arjana Fullani, *E drejta familjare*, Tiranë, 2006
- Cvetanka Siljanoska-Kostadinovska, *Posvojuvanjeto kako eden od vidovite na zastita na decata*, Shkup, 2005
- Gani Oruçi, *E drejta familjare*, Prishtinë, 1994
- Kiril Cavgar, *Komentar na Zakonot za semejstvoto*, so sudska praktika, obrasci za prakticna primena, predmeten registar i pridruzni propoisi, Skopje, 1998
- Liljana Spirovic, *Semejno Pravo*, Shkup, 2004
- Marija Draškić, *Porodično pravo i pravo deteta*, Beograd, 2005
- Mira Alinčić, Dubravka Hrabar, Dijana Jakovac-Lozić, Aleksandra Korać-Graovac, *Obiteljsko Pravo*, Zagreb, 2007

II

- Ustav na RM. 1991
- Zakon za semejstvoto (precisten tekst), Sluzben vesnik na RM br. 83/2004
- Zakon za penziskoto i invalidskoto osiguruvanje, Sluzben vesnik na RM br.80/1993
- Zakon za zastita na decata, Sluzben vesnik na RM br.98/2000
- Zakon za socijalnata zastita, (precisten tekst), Sluzben vesnik na RM br. 21/2006
- Ligji për procedurat e birësimit dhe Komitetit shqiptar të birësimit, Nr.9695, viti 2007
- Ligji për familjen i Kosovës, Nr.32/2004
- Obiteljski Zakon Republike Hrvatske, Narodne novine 116/03
- European Convention on the Adoption of Children, Strasbourg, 24 April 1967
- European Convention on Adoption , Strasbourg, 7 May 2008

- Convention on the Rights of the Child, 20 November 1989
- Hague Convention on Protection of Children and Co-Operation in Respect of Intercountry Adoption, 29 May 1993

III

- *Strucno-metodolosko upatstvo za sproveduvanje na posvojuvanjeto*, Javna Ustanova Zavod za socijalni dejnosti, Skopje, 1999
- *Strucno – metodoloski upatstva i priracnici, Dokumenti-* kniga 1, tom 2, Javna Ustanova Zavod za Socijalni dejnosti, Skopje, 2007
- *Socijalna slika na Republika Makedonija*, Ministerstvo za trud i sociajalna politika Skopje, 2008
- *Formi, merki i uslugi na socijalnata zastita*, 2007, br. 2.1.8.4, Drzaven zavod za statistika, Skopje, 30.05.2008
- Shtypi ditor ‘Utrinski Vesnik’